



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE  
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Durrës, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Drejtuar: KOMBEAS me Nipt: K88103301J, Adresa: Lezhe Milot Fshati Prozhme, Rruga Dod Llesh, ne pasurine me nr.6/50, Zona Kadastrale 3441.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur (punë).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04942-09-09-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion dhe shtesë qendra shëndetësore Spitallë”, me fond limit: 19.542.800 lekë, sasia: sipas preventivit, afati: 56 ditë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE MF INVEST GROUP me nipt L71830010R +I.C.C GROUP me nipt L51308006A me vlerë 12.368.396 (dymbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë
2. KOMBEAS me Nipt: K88103301J me vlerë 13.348.765 (trembëdhjetë milion e treqind e dyzetë e tetëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë ) lekë
3. NIKA me Nipt: J767050047U , me vlerë 13.635.398 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë
4. 2 N me Nipt: L31615017L, me vlerë 14.414.360 (katërbëdhjetë milion e katërqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë

5. EURONDERTIMI 2000 me Nipt: K02003001O , me vlerë 14.545.416 (katërbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.
6. BOE DAJTI PARK 2007 me Nipt: K11507003S  
+ ALTEC me Nipt:K57923807W, me vlerë 14.692.835(katërbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjet e pesë) lekë.
7. GLAVENICA me Nipt: K17710805A, me vlerë 15.234.076 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë e gjashtë)lekë.
8. AVDULI me Nipt: J66703306OE, me vlerë 15.400.335 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e mijë e treqind e tridhjet e pesë)lekë
9. BOE ERIL B&B me Nipt: L81426509M + LLAZO me Nipt: K24218401K, me vlerë 15.548.147 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e tetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë)lekë
10. SARK me Nipt: K52531415H, me vlerë 16.308.965 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë
11. L.T.E CONSTRUCTION me Nipt: L78006801F, me vlerë 16.698.453(gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë
12. LIQENI VII me Nipt: K01730502W ,me vlerë të ofertës 18.083.632 (tetëmbëdhjetë milion e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekë
13. EURO-ALB me Nipt: K66613407H, me vlerë të ofertës 18.273.189(tetëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë
14. BE – IS SH.P.K me Nipt: K71412003A, me vlerë të ofertës 18.886.329 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzetë e nëntë) lekë
15. ELDA-VL me Nipt: K67106202W nuk ka paraqitur ofertë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

-Për operatorin ekonomik BOE MF INVEST GROUP me nipt L71830010R + I.C.C GROUP me nipt L51308006A, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se ofertuesi nuk ka përfshirë në ofertën e tij shumën II “Makineri dhe paisje” në vlerën 2.142.500 lekë, duke shtuar vlerën e shumës II “Makineri dhe paisje” oferta shkon në vlerën 14.510.896,25 lekë. Referuar pikës 3 të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 neni 82 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ofertat refuzohen, kur: shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. *KVO vendos që operatorin ekonomik BOE MF INVEST GROUP+I.C.C GROUP, të mos kualifikohet.*

-Për operatorin ekonomik BOE DAJTI PARK 2007 me Nipt: K11507003S+ ALTEC me Nipt:K57923807W, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

## Për KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Për operatorin ekonomik BOE DAJTI PARK 2007 + ALTEC mungon pika e mësipërme.

Për pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar gërma b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kandidatit ALTEC, i mungojnë bilancet vjetore.

Për pikën 2.3 Kapaciteti teknik gërmat b, h dhe i:

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë
- NP-2 A – Ndërtime civile dhe industriale
- NS-1 A- Punime për prishjen e ndertimeve
- NS-2 A- Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- NS-4 A- Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
- N.S – 12A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS- 14A- Impiante të brendshëm, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV
- NS- 18A – Punime topogjeodezike.

h. Certificate: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certificate të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi.

i. Certificate: ISO 18001/45001 - Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certificate të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kandidatit ALTEC, i mungojnë pikat e mësipërme.

*KVO vendos që operatori BOE DAJTI PARK 2007+ALTEC , të mos kualifikohet.*

-Për operatorin ekonomik BOE ERIL B&B me Nipt: L81426509M + LLAZO me Nipt: K24218401K, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

Për pikën 2.3 Kapaciteti teknik gërma e. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- hekurthyes 3 (tre)
- Punëtorë ndërtimi të thjeshtë 12 punonjës

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

*Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.*

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

Kandidatit BOE ERIL B&B + LLAZO i mungonë 2 punëtorë të thjeshtë dhe 1 hekurthyes tek vetëdeklarimi sipas shtojcës 8.

*KVO vendos që operatori BOE ERIL B&B + LLAZO, të mos kualifikohet.*

-Për operatorin ekonomik SARK me Nipt: K52531415H , Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

Për pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar gërma b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar,

Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kandidatit SARK, i mungojnë Akt Ekspertizat e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.

Për pikën 2.3 Kapaciteti teknik gërma a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 9'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 36'000'000 lekë.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

*Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

Kandidatit SARK nuk i plotëson përvojat e mëparshme.

*KVO vendos që operatori SARK, të mos kualifikohet.*

-Për operatorin ekonomik L.T.E CONSTRUCTION me Nipt: L78006801F, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

Për pikën 2.3 Kapaciteti teknik gërmat d dhe e:

d. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Inxhinjer Gjeodet 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/liçenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale e teknikut të ndertimit ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

Kandidatit L.T.E CONSTRUCTION i mungon inxhinieri Gjeodet.

e. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- karpentier 3(tre)
- hekurthyes 3 (tre)
- hidraulik 2 (dy)
- murator 4 (kater)
- bojaxhi 3 (tre)
- Punëtorë ndërtimi të thjeshtë 12 punonjes

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

*Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.*

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

Kandidatit L.T.E CONSTRUCTION i mungon 1 karpentier, 1 hekurkthyes, 1 hidraulik, 2 murator, 1 bojaxhi dhe 12 puntorë të thjeshtë dhe 1 hekurkthyes tek vetëdeklarimi sipas shtojcës 8.

*KVO vendos qe operatori L.T.E CONSTRUCTION, të mos kualifikohet.*

-Për operatorin ekonomik LIQENI VII me Nipt: K01730502W, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

Për pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar gërma b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kandidatit LIQENI VII, i mungojnë bilancet vjetore.

*KVO vendos qe operatori LIQENI VII, të mos kualifikohet.*

-Për operatorin ekonomik ELDA-VL me Nipt: K67106202W nuk ka paraqitur oferte, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

Operatori ELDA-VL ka paraqitur një folder me emërtimin formulari i ofertës ekonomike bosh dhe asnjë dokumentacion tjetër.

*KVO vendos qe operatori ELDA-VL, të mos kualifikohet.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *KOMBEAS me Nipt: K88103301J*

Me adrese: Lezhe Milot Fshati Prozhme, Rruga Dod LLeshi, ne pasurine me nr.6/50, Zona Kadastrale 3441, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 13.348.765 (*trembëdhjetë milion e treqind e dyzetë e tetëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë* ) lekë /totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Emiriana Sako**